

PLANI I INSPEKTIMEVE 2021

INSPEKTORATI SHETËROR I MBIKËQYRJES SË TREGUT

QËLLIMI:

Përmirësim i sigurisë së produkteve për konsumatorët dhe respektimi i të drejtave të pronësisë intelektuale

OBJEKTIVI 1:

Zbatimi i kërkesave ligjore nga subjektet konform legjislacionit në fuqi për ofrimin e produkteve, pajisje/instalime të sigurta për konsumatorin si dhe për respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale.

STRATEGJIA PËR REALIZIMIN E OBJEKTIVIT:

Kryerje inspektimesh për kontrollin e zbatimit të kërkesave ligjore nga ana e operatorëve ekonomikë

AKTIVITETET:

- i. Inspektime për produktet mekanike
- ii. Inspektime për produktet elektrike
- iii. Inspektime për instrumentat matëse ligjërisht të kontrolluara dhe parapaketim
- iv. Inspektime për sigurinë e përgjithshme (lodra, detergjentë, artikuj të kujdesit për fëmijë, zbatimi i Ligjit për mbrojtjen e konsumatorit, kimikate, etj)
- v. Inspektime për zbatimin e të drejtave të autorit dhe të drejtat e tjera lidhur me to
- vi. Inspektime për pronësinë industriale

INDIKATOR: Numër inspektimesh

Numri total i inspektimeve që do të kryejtë ISHMT për vitin 2021 është 3140 inspektime nga të cilat 668 pa planifikim dhe 2472 me planifikim të cilat janë llogaritur duke patur në konsideratë Metodologjinë e IQ

Inspektimet sipas fushë veprimtarisë ndahen në I) inspektime për mbikëqyrjen e tregut që do të kryhen nga Drejtoria e Drejtoria e Mbikëqyrjes së Produkteve (DMP) dhe II) inspektime për pronësinë intelektuale që do të kryhen nga Drejtoria e Pronësisë Intelektuale (DPI)

Numri total i inspektimeve që do të kryehen nga DMP për vitin 2021 do të jetë **2317 inspektime** në vit nga të cilat **463 janë të paplanifikuara dhe 1854 inspektime me planifikim.**

Fushat e kryesore në të cilat DMP planifikon të ndërmarri inspektime për vitin 2021 janë:

- Inspektimi i ashensorëve të vendosur përherë të parë në treg dhe në përdorim;
- Inspektimi i Makinerive;
- Inspektimi instrumentave matës të vendosur në treg dhe në përdorim;
- Inspektimi i Lodrave;
- Inspektimi i Detergjentëve;
- Inspektimi mbi bazën e Ligjit për Mbrojtjen Konsumatore ;
- Inspektimi për zbatimin e kërkesave ligjore sipas legjislacionit për sigurinë e përgjithshme dhe legjislacionin në fuqi për kimikatet e rrezikshme në artikuj (lodrat në sheshe, tekstile, veshjet e fëmijëve, artikuj të kujdesit etj.).

Numri total i inspektimeve që duhet të kryhen nga DPI do të jenë **823 inspektime nga të cilët 205 pa planifikim dhe 618 me planifikim.**

Spektori i t të Drejtav të Autorit do të kryej **773 inpektime.**

Fushat e kryesore në të cilat ky sektor planifikon të ndërmarri inspektime për vitin 2020 janë:

- Inspektimi i programeve kompjuterike
- Inspektimi i veprave audio-vizuale
- Inspektimi i veprave letrare (shtëpi botuese, fotokopje, shtypshkonjë, etj)

Përsa i përket *Sektorit të Pronësisë Industriale* nuk mund të planifikohen inspektimet sipas metodologjisë së IQ pasi referuar Ligjit 9947, datë 7.7.2008 “Për Pronësinë Industriale” , institucioni mund të kryejë inspektime vetëm në bazë ankese dhe ex officio. Për vitin 2020 **parashikohet një numër prej 50 inspektimesh të paplanifikuara**, numër që mund të ndryshojë në varësi të ankesave të ardhura nga mbajtësit e të drejtave apo përfaqësuesit ligjor.

Numri total i inspektimeve të ISHMT është llogaritur duke zbritur 30% nga numri total që del sipas metodologjisë së IQ për arsytet si më poshtë:

- ISHMT funksion si Drejtori Qendrore por mbulon gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe në këto kushte ka mungesa në logjistikë . Numër shumë i kufizuar i mjeteve të transportit dhe mungesë të kiteve të inspektimit.
- Ka inspektime në disa fusha si p.sh metrologji, e drejta e autorit, siguria e përgjithshme që kërkojnë më shumë kohë në verifikime dokumentash dhe prova laboratorike.
- Vështirësitë për shkak të situatës së krijuar nga Covid 19 që pritet të ketë ndikime edhe në vitin 2021.

OBJEKTIVI 2: Rritje e ndërgjegjësimit të operatorëve ekonomik mbi kriteret ligjore që duhet të zbatohen në fushën e sigurisë së produkteve joushqimore dhe pronësisë intelektuale dhe të konsumatorëve mbi të drejtat e tyre

STRATEGJIA PËR REALIZIMIN E OBJEKTIVIT:

- 2.1. Ndërgjegjësimi i operatorëve ekonomikë mbi sigurinë e produkteve jo ushqimore dhe mbi të drejtat e pronësisë intelektuale
- 2.2. Fuqizimi i kapaciteteve njerëzore të ISHMT nëpërmjet trajnimeve dhe pjesëmarrjes në aktivitete të ndryshme.

AKTIVITETE

2.1. Gjatë vitit 2021 do të organizohen **takime sensibilizuese** me operatorë ekonomikë në lidhje me sigurinë e ashensorëve, të lodrave, detergjentëve, metrologjisë, të drejtave të pronësisë industriale, etj. Gjithashtu do të organizohen takime me përfaqësues të bashkive për matësit e ujit.

Do të realizohen **botime/fletpalosje** sensibilizuese/informuese.

Do të përditësohet në mënyrë të vazhdueshme **faqja zyrtare e ISHMT-se** me informacione për operatorët ekonomikë dhe konsumatorët.

2.2. Në lidhje me ngritjen e kapaciteteve njerëzore të ISHMT-së, do të vazhdojnë trajnime të stafit sipas fushave specifike me mbështetjen e Projektit PTB si dhe të donatorëve të tjerë. Në lidhje me inspektorët e rinj (në kohë prove) do të realizohen trajnime për njohjen dhe përdorimin e sistemit e-inspektim., të procedurave të inspektimit referuar zbatimit të Ligjit Nr.10433 “Për inspektimin në RSH”, etj.

INDIKATOR 2.1. Numër operatorësh të sensibilizuar dhe informuar; Numër aktiviteteve sensibilizuese;

INDIKATOR 2.2: Numër trajnimesh; Numër personash të trajnuar.

Nr	DPA/Drejtorite/Sektoret/Qarqet	Oret qe duhen per nje inspektim (ore)	Dite vjetore te inspektimit per nje inspektor (dite)	Oret vjetore te inspektimit per nje inspektor (ore)	Numri total i inspektoreve	Numri i inspektoreve ne grup	Numri i grupeve te inspektimit	Numri i inspektimeve ne 1 dite	Totali i inspektimeve sipas metodologjise IQ	Totali inspektimeve	% e inspektimeve te paplanifikuara (20%)	Totali i inspektimeve te paplanifikuara	Totali i inspektimeve te planifikuara	
1	DREJTORIA E MBIKËQYRJES SË PRODUKTEVE													
1.1	Spektori i Produkteve Mekanike	4	138	552	4	2	2	2	552	386	20%	77	309	
1.2	Spektori i Produkteve elektrike	4	138	552	4	2	2	2	552	386	20%	77	309	
1.3	Spektori i Inspektimit Metrologjik	4	138	552	13	2	6	2	1656	1159	20%	232	927	
1.4	Spektori Kimik dhe Siguria e Pergjithshme	4	138	552	5	2	2	2	552	386	20%	77	309	
	TOTALI DMP				26				3312	2317		463	1854	
2	DREJTORIA E PRONËSISË INTELEKTUALE													
1	Spektori i të drejtave të autorit	4	138	552	9	2	4	2	1104	773	20%	155	618	
	Spektori i Pronësisë Industriale	4	138	552	6	2	3	2	0	50	20%	50	0	
	TOTALI DPI				15				1104	823		205	618	
	TOTALI ISHMT				41				4416	3140		668	2472	

*: Për Sektorin e Pronësisë Industriale në Drejtorinë e Pronësisë Intelektual 100 inspektimet janë të paplanifikuara sepse ky sektor kryen inspektime vetëm mbi bazë ankese. Sektori i të drejtave të autorit do të kryejë 828 inspektime dhe të paplanifikuara ka llogaritur vetëm 10% jo 20%.